



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGGJITHSHME E RRUGËVE DHE NDRIÇIMIT PUBLIK

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Datë: 09.11.2021

Drejtuar: Operatorit Ekonomik “**LIGUS sh.p.k**” me adresë: Rruga: Mark Bazati, Pallati Jora Shpk, Kati perdhës, Dyqani/Magazina me Nr.1 , Kashar, Tirana.

Procedura e prokurimit/lotit: E hapur e thjeshtuar.

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-08585-10-18-2021

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Blerje disqe për asfalt” me afat lëvrimi brenda 10 (dhjetë) ditëve nga nënshkrimi i kontratës, fondi limit 1.010.000 (një milion e dhjetë mijë) lekë pa TVSH.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 154, datë 25.10.2021.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara

1.Operatori ekonomik AZ Trading sh.p.k me NUIS L81515016F me adresë: Tirane Njesia Administrative nr.7, Bulevardi Gjergj Fishta, Kulla G&P, Kati 1, Njesia nr.13 dhe me ofertë ekonomike 1.004.000 (një milion e katër mijë) lekë pa tvsh.

2.Operatori ekonomik HEST sh.p.k me NUIS L21527009H me adresë: Bulevardi "Gjergj Fishta", Kulla Nr 1, Kati 1 , Tirane, Tirana dhe me ofertë ekonomike 984.000 (nëntëqind e tetëdhjet e katër mijë) lekë pa tvsh.

3.Operatori ekonomik LIGUS sh.p.k me NUIS L51523001S me adresë: Mark Bazati, Pallati Jora Shpk, Kati perdhës, Dyqani/Magazina me Nr.1,Kashar,Tirana dhe me ofertë ekonomike 997.000 (nëntëqind e nëntëdhjet e shatë mijë) lekë pa tvsh.

4.Operatori ekonomik LUAR Bros sh.p.k me NUIS L72322004M me adresë: Rruga "Nasi Pavllo", pall 15/1, Shkalla 1, Apartamenti nr.1,Tirane dhe me ofertë ekonomike 960.000 (nënëtdëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë pa tvsh.

5.Operatori ekonomik MUCA sh.p.k me NUIS K01421002H me adresë: Tirane,Vore, Picar,Autostrada Tirane-Durres, km.13, dhe me ofertë ekonomike 766.500(shatëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind) lekë pa tvsh.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1.Operatori ekonomik AZ Trading sh.p.k me NUIS L81515016F.

2.Operatori ekonomik HEST sh.p.k me NUIS L21527009H.

3.Operatori ekonomik LUAR Bros sh.p.k me NUIS L72322004M.

4.Operatori ekonomik MUCA sh.p.k me NUIS K01421002H.

Për arsyet e mëposhtme:

1.“AZ Trading” sh.p.k

Nuk përmbush pikën 2.3.4 të kapacitetit teknik ku parashikohet se *“Operatori ekonomik duhet të paraqesë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, në orën e përcaktuar për hapjen e ofertave në dokumentat e tenderit, nga një mostër për secilin disk. Mosparaqitja e mostrës përbën shkak për skualifikim”* pasi nuk ka paraqitur mostrat në datën dhe orën e përcaktuar në DST

2.“HEST” sh.p.k

Nuk përmbush pikën 2.3.2 të kapacitetit teknik ku parashikohet se: *“Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose nga distributori i autorizuar nga prodhuesi, për mallin objekt prokurimi. Në rast se do të paraqitet kjo e fundit, duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.”* pasi operatori ekonomik nuk ka paraqitur një dokument që të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit.

Nuk përmbush pikën 2.3.4 të kapacitetit teknik ku parashikohet se *“Operatori ekonomik duhet të paraqesë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, në orën e përcaktuar për hapjen e ofertave në dokumentat e tenderit, nga një mostër për secilin disk. Mosparaqitja e mostrës përbën shkak për skualifikim”*. Nga verifikimi i mostrës së paraqitur pranë AK në datën dhe orën e hapjes së ofertave rezulton se mostra e paraqitur nga OE për artikullin disk sharre për prerje betoni rezulton se ka të shënuar në trupin e diskut cilësine Bronze dhe jo gold siç është kërkuar nga AK.

3.“LUAR Bros” sh.p.k

Nuk përmbush pikën 2.3.2 të kapacitetit teknik ku parashikohet se: *“Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose nga distributori i autorizuar nga prodhuesi, për mallin objekt prokurimi. Në rast se do të paraqitet kjo e fundit, duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.”* pasi operatori ekonomik nuk ka

paraqitur një dokument që të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit.

4. "MUCA" sh.p.k

Nuk përmbush pikën 2.3.4 të kapacitetit teknik ku parashikohet se *"Operatori ekonomik duhet të paraqesë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, në orën e përcaktuar për hapjen e ofertave në dokumentat e tenderit, nga një mostër për secilin disk. Mosparaqitja e mostrës përbën shkak për skualifikim"* Nga verifikimi i mostrës së paraqitur pranë Autoritetit Kontraktor në datën dhe orën e hapjes së ofertave rezultojnë se mostra e paraqitur nga Operatori Ekonomik për artikullin disk sharrë për prerje betoni rezultojnë se ka të shënuar në trupin e diskut 2 pika nga 3, rrjedhimisht nuk është i cilësisë maksimale siç është kërkuar nga Autoritetit Kontraktor.

Nuk përmbush pikën 2.3.1 të kapacitetit teknik ku parashikohet *"Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate. Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:*

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Vlera e furnizimeve të ngjashme të paraqitura nga operatori ekonomik është 41,757 lekë pa tvsh kurse 20% i vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate është 202.000 lekë pa tvsh. Rrjedhimisht, operatori ka paraqitur një vlerë më të vogël se ajo e kërkuar referuar kërkesës së mësipërme.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin **"LIGUS" sh.p.k** me NUIS L51523001S me adresë: Rruga Mark Bazati, Pallati Jora Shpk, Kati perdhës, Dyqani/Magazina me Nr.1, Kashar, Tirana dhe me ofertë ekonomike 997.000 (nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë) lekë pa tvsh. është identifikuar si Oferte e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik".